



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2699/9 prot.,

Tiranë, më 14.08.2023

VENDIM

Nr. 56, datë 14.08.2023

**“PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË BUXHETIT PËR PROJEKTIN
“VLERËSIMI I PROTEZAVE FIKSE METAL QERAMIKË DHE TOTAL
QERAMIKË TË MBËSHTETURA MBI IMPLANTE” NË KUADËR TË
NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT, PËR VITIN
AKADEMIK 2022-2023, PËR FAKULTETIN E MJEKËSISË DENTARE, NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Statutin e UMT-së, Urdhërin nr. 468, datë 02.08.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për financim/bashkëfinancimin e projekteve të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2022-2023”; Vendimin e Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë Dentare, nr. 467/2 prot., datë 01.09.2022 “Mbi shtesën e buxhetit për projektet e miratuara nga MAS për vitin 2022”; Vendimin e Rektoratit nr.10, datë 29.06.2023; Vendimin e Senatit Akademik nr. 79, datë 30.06.2023, pasi mori në shqyrtim Relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 2000/7 prot., datë 19.07.2023 ““Kërkesë për miratim të rishpërndarjes së buxhetit të projektit me titull “Vlerësimi i protezave fikse metal qeramikë dhe total qeramikë të mbështetura mbi implante” të Fakultetit të Mjekësisë Dentare””, në mbledhjen datë 14.08.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë rishpërndarjen e buxhetit për projektin me titull “Vlerësimi i protezave fikse metal qeramikë dhe total qeramikë të mbështetura mbi implante” në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2022-2023, për Fakultetin e Mjekësisë Dentare në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
2. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqjen zyrtare të UMT-së.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI

ANËTARË

VERA OSTRENI

ALTINA XHAFERI

ALBANA GJINOPULLI

ENDRIT YZEIRAJ

MONIKA FIDA

ANIS THODHORJANI